



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH. a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION I.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.



Për:  
**Ymer Fejzullahu**  
Kryesues i Bordit të ZRRE

Kopje:  
**Artane Rizvanolli**  
Ministre – Ministria e  
Ekonomisë  
**Bordi i KEK**  
**Bordi i ZRRE**

Data: 03.03.2023

Nga: **Nagip Krasniqi**  
Kryeshef Ekzekutiv  
Korporata Energjetike e Kosovës  
Sheshi Nënë Tereza nr. 36  
Prishtinë, 10000  
Republika e Kosovës  
[www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com)

### **Çështja: Komentet e KEK në Raportin Konsultativ.**

I nderuar z. Fejzullahu,

Siç jeni në dijeni, Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a është kompani e licencuar pran ZRRE-së për prodhim të energjisë elektrike në njësitë gjeneruese të TC Kosova A dhe bashkëprodhim të energjisë elektrike dhe termike në njësitë gjeneruese të TC Kosova B. Duke filluar nga 01 prill 2017, KEK nuk i nënshtrohet rregullimit të çmimit të energjisë elektrike i cili prodhohet në njësitë gjeneruese, mirëpo, marrë parasysh që vendimmarrja e ZRRE-së tek operatorët e rregulluar, reflekton në çmimin e energjisë elektrike me shumicë me të njëjtit.

Pas ne konsiderate rolin e KEK-ut në tregun e energjisë, ne me anë të kësaj shkrese paraqesim komentet tona në Raportin Konsultativ “Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm i të Hyrave të Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar”.

Duke mos dashur të komentojmë gjithë përmbajtjen e Raportit Konsultativ, fokusi ynë është vetëm tek kostot shtesë të cilat barten nga rritja e tarifave të KOSTT-it tek KEK-u dhe rritjen e kostos së prodhimit të energjisë. Njëkohësisht ne potencojmë faktin që duke u nisur nga periudha Tetor 2021 deri në fund të vitit 2023 me tarifatat aktuale, kostoja shtesë e pa mbuluar në tarifatat e KEK-ut arrin shifrën rreth 10.1 milion euro. Prandaj, KEK kërkon nga Bordi i ZRRE-së, që kostot e mësipërme dhe kostot shtesë nëse do të ketë, të njëjtat të reflektohen edhe tek kostot e blerjes së energjisë vendore me anë të cilëve KEK do të mund të kompensojë diferencën e kostos shtesë në çmimin e energjisë elektrike me shumicë.

Pas parasysh që marrëveshja aktuale për çmime me palët KEDS, KESCO dhe KOSTT skadon me datën 31.03.2023 dhe faktin që çmimet aktuale nuk mbulojnë koston mesatare të prodhimit të energjisë elektrike nga Termocentralet, duke përfshirë edhe koston e eksploatimit të thëngjillit për qëllim të prodhimit të energjisë elektrike (shih bashkangjitur raportin e auditimit për pasqyrat e shturura 2021 dhe kalkulimin e çmimit për vitin 2022), kostoja mesatare e vlerësuar për vitin 2022 sipas Draft Pasqyrave Financiare është 31.25 €/MWh. Andaj, për periudhën e ardhshme duke filluar nga 01.04.2023, KEK kërkon nga palët që të reflektojnë koston mesatare të prodhimit të energjisë elektrike si dhe mbulimin e kostove shtesë që barten nga rritja e tarifave të KOSTT.

Vlen të theksohet se përkundër faktit që çmimet e furnizimeve kryesore kanë pësuar rritje drastike në treg, çmimet e energjisë elektrike të Korporatës Energjetike të Kosovës nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim që nga viti 2019 duke e rritur ekspozimin e Korporatës për të operuar me humbje.

Korporata Energjetike e Kosovës me qëllim të krijimit të stabilitetit për sigurinë e furnizimit me energji elektrike përmes realizimit të investimeve kapitale kërkon nga ZRRE që në të hyrat e lejuara maksimale për palët KEDS, KESCO dhe KOSTT të reflektoje koston reale për prodhim të energjisë elektrike nga KEK-u. Çmimet e rishikuara nga KEK-u për periudhën e cila fillon nga data 01.04.2023 deri 31.03.2024 duhet të reflektohen si vijojnë:

- Çmimi i energjisë Elektrike për mbulimin e Furnizimit për Shërbim Universal - 32.40 €/MWh;
- Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në shpërndarje – 39.54 €/MWh;
- Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në transmetim – 39.54 €/MWh;

Korporata Energjetike e Kosovës është e gatshme që të ju ofroj të gjitha informatat tjera relevante që ju i konsideroni të nevojshme të cilat mund të kontribuojnë në procesin e vendimmarrjes tuaj.

Me respekt,

  
Nagip Krasniqi

Kryeshef Ekzekutiv

